




REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK1
N. 01-611/2012
20.02.2012

02

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	20.02.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Ibrahim Hoxha Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Podujevës.
CC:	z. Agim Veliu Kryetar i Komunën e Podujevës.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Furnizimi me derivate të naftës për nevoja të institucioneve komunale".



I nderuari z. Hoxha

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Furnizimi me derivate të naftës për nevojat të Institucioneve Komunale". numri prokurimit 615-12-005-121 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra Prokurimit – Komuna Podujevës t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

A r s y e t i m

Zyra e prokurimit në Komunën e Podujevës, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Furnizim " të procedurës së hapur me nr. të prokurimit 615-12-005-121 me titull "Furnizimi me derivate të naftës për nevojat e institucioneve komunale" , në Pjesën,

Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit te neni 5.3 i Dosjes së tenderit , ka kërkuar që afati kohor për fillim ose përfundimin e kontratës : tri dite pas nënshkrimit të kontratës për 12 muaj me mundsi vazhdimi edhe për 12 muaj tjerë.

Autoriteti kontraktues gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit dhe publikimit të njoftimit për kontratë në ueb faqen e KRPP-së, ka mospërputhje në mesë këtyre dokumenteve (deri sa te njoftimi për kontratë ka shpallur tenderin kontratën publike kornizë ndërsa te dosja e tenderit nuk figuron se është kontratë publike kornizë) , nga kjo rrjedh se departamenti prokurimit ka shkelur nenin 27 të LPP-së 04/L-042.

Po ashtu zyra prokurimit te fleta e të dhënave të tenderit te neni 9.1 i Dosjes së tenderit te Kërkesat mbi mundësit teknike dhe /ose profesionale pika 4 Dokumentet e Kërkuara - ka kërkuar , Pika furnizuese e O.E nuk mund të jetë më largë se 4 km nga qendra e qytetit nga kjo rrjedh se departamenti prokurimit ka ber diskriminim territorial gjë që paraqet shkelje të nenit 7 pika 4 LPP-së 04/L-042.

Me respekt!

